



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PA1 Nr.08-204
24.07.2024
Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 2, neni 82 paragrafi (1) nënparagrafët 5 dhe 6 dhe neni 83 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele - LSHMAAV („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23 dhe 55/24), dhe në lidhje me nenin 62 paragrafi (6) nga Ligji i njëjtë, neni 21 nga Rregullorja për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3953/1 datë 31.10.2023, neni 80 paragrafi (5) të LSHMAAV, neni 51 paragrafi (1) dhe paragrafi (3) dhe neni 52 paragrafi (2) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr.124/15), neni 28 nga Ligji i Kontesteve Administrativ („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr.96/19), neni 24 nga Rregullorja për procedurat e punës financiare dhe kontabël të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, ark.nr.01-6222/1 datë 12.12.2014, duke vepruar sipas Propozimit PA1 nr.08-204 datë 09.07.2024, për inicim të procedurës për heqjen dhe Propozimin PA1 nr.08-204 datë 22.07.2024 për miratimin e vendimit për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë, në pajtim me Konkluzionin, ark. nr.02-3159/2 datë 24.07.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 30-të mbajtur më 24.07.2024 miratoi:

VENDIM
për marrjen e lejes për transmetim televiziv të
Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë

1. I HIQET leja për transmetim televiziv, PA1 nr.08-816 datë 07.09.2023, Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë, për shkak se pas dhënies së lejes janë krijuar rrethana që paraqesin pengesa ligjore për zotëruesin e lejes për kryerjen e veprimtarisë, gjegjësisht për shkak se transmetuesi nuk i ka plotësuar kushtet minimale kadrovike të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio dhe për mos pagesë të kompensimit vjetor për lejen e transmetimit televiziv në afatin e përcaktuar ligjor – 30 ditësh nga dita e pranimit të Faturës nr.2024-100-0148 datë 30.05.2024, (nr.yinë ark.05-2565/1 datë 30.05.2024).

2. Fatura 2024-100-0148 datë 30.05.2024 (nr.yinë ark.05-2565/1 datë 30.05.2024), anulohet dhe subjektit nga pika 1. i këtij Vendimi, i jipet faturë e re, e cila i referohet vetëm periudhës së punës, pra deri në ditën e marrjes së këtij vendimi për heqjen e lejes, e cila duhet të paguhet jo më vonë se 8 (tetë) ditë nga dita e dhënies së saj.

3. Ky vendim botohet në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“, në ueb faqen e Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe në dy gazeta ditore, prej të cilave njëra është në gjuhën e bashkësive joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

4. Ky Vendim është përfundimtar.

Arsyetim

Shoqëria Tregtare për Radiodifuzion TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë, është zotërues i lejes për transmetim televiziv, PA1 nr.08-816 datë 07.09.2023, për transmetim nëpërmjet operatorit të rrjetit publik të komunikimit elektronik i cili nuk shfrytëzon resurs të kufizuar, për zonën D4 - Boskija (Radovish, Konçe, Vasilevo, Bosilovo, Strumicë, Novo Sellë, Valandovë, Bogdanci, Dojran, Gjevgjeli), shërbime programore televizive me format të përgjithshëm kryesisht argëtues, në gjuhën maqedone.

I. Në pajtim me nenin 62 paragrafi (6) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) për sigurimin (ofrimin) e transmetimit televiziv dhe radio, përveç kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj, transmetuesi duhet të përmbushë dhe kushte të veçanta minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike në varësi të formatit programor, përcaktuar me aktet nënligjore të miratuara nga Agjencia.

Neni 21 i Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për dhënien e lejes për transmetim televiziv dhe radio, parasheh se zotëruesi i lejes për transmetim televiziv të shërbimit programor me format të përgjithshëm është i detyruar në marrëdhënie të rregullt pune, të ketë së paku 5 (pesë) persona, pjesëmarrës në krijimin e programit, nëse ka leje për transmetim të programit në zonat: D1-Crn Vrv – Veles, D2-Stacin, D3-Turtel, D4-Boskija, D5-Pelister, D6-Mali Vlaj dhe D8-Kodra e Diellit, si dhe redaktori përgjegjës i shërbimit programor me format të përgjithshëm dhe të specializuar duhet të jetë në marrëdhënie të rregullt pune.

Më 10.06.2024, Agjencia e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) drejtuar Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë i dërgoi Kërkesë, ark.nr.03-2694/1, me të cilën kërkoi që në afat prej shtatë ditësh nga dita e pranimit të shkresës të dorëzoi dokumentet - Fletëparaqitje/Çregjistrim nga Enti Shtetëror për Punësim – Formular M1/M2, të dhëna nga Agjencia për Punësim e RMV-së, nga e cila do të mund të konstatohet se i përmbush kushtet minimale kadrovike të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për dhënien e lejes për transmetim televiziv dhe radio. Kërkesa është pranuar nga transmetuesi më 14.06.2024, ndërsa afati për dorëzim të dokumenteve ka skaduar (përfunduar) më 21.06.2024. Përfundimisht, deri më 02.07.2024, transmetuesi nuk i ka dorëzuar Agjencisë dokumentacionin e nevojshëm.

Në pajtim me nenin 27 paragrafi (1) të LSHMAAV, Agjencia kryen mbikëqyrje administrative, i cili kryhet mbi punën e botuesve të mediave nga aspekti i harmonizimit të punës së tyre me kushtet e përcaktuara në Ligjin për Media, Ligjin e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe dispozitave të miratura në bazë të Ligjit (neni 29 paragrafi 1 nga LSHMAAV).

Në lidhje me sa mësipër, Agjencia përmes Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit, ka kryer mbikëqyrje të jashtëzakonshme administrative të punës së Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë, ku në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer të jashtëzakonshme administrative, ark.nr.03-2925/1 datë 02.07.2024, është konstatuar se transmetuesi nuk i përmbush kushtet minimale kadrovike të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për dhënien e lejes për transmetim televiziv dhe radio.

II. Në pajtim me nenin 80 paragrafi (1) të LSHMAAV, për lejen e transmetimit televiziv dhe radio transmetuesit, me përjashtim të shërbimit publik radiodifuziv, paguajnë kompensim vjetor në llogari të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) në pajtim me Ligjin. Kompensimi vjetor paguhet për çdo vit aktual, duke filluar nga data e dhënies së lejes për transmetim televiziv dhe radio në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të faturës së dhënë nga Agjencia (neni 80 paragrafi 5 nga LSHMAAV).

Në lidhje me kompensimin vjetor për lejen e transmetimit televiziv të Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë, PA1 nr.08-816 datë 07.09.2023, Agjencia më 30.05.2024, dërgoi Faturë nr.2024-100-0148 datë 30.05.2024. (nr ynë.ark.05-2565/1 datë 30.05.2024) për kompensimin e lejes, në pajtim me transmetuesin që kishte për detyrim të paguajë shumën prej 278.538,00 (dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e tridhjetë e tetë) denarë, për kompensim vjetor për lejen e transmetimit televiziv, për periudhën nga 27.05.2024, deri më 26.05.2025. Në Agjenci është dorëzuar letër kthyesë nga SHA Posta e Maqedonisë e RMV-së, për pranimin e faturës më 03.06.2024.

Agjencia përmes Sektorit për financa dhe logjistikë, ka kryer mbikëqyrje administrative të punës së Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë, në aspekt të përmbushjes së detyrimit për pagesë të kompensimit vjetor për lejen, nga ku pas kryerjes së mbikëqyrjes së rregullt administrative, në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative (nr ynë.ark.05-2943/1 datë 04.07.2024), është konstatuar se transmetuesi në fjalë nuk e ka përmbushur detyrimin ligjor të paraparë në nenin 80 paragrafi (5) të LSHMAAV, pra nuk ka paguar kompensim vjetor për lejen e transmetimit televiziv në llogari të Agjencisë.

Përkatësisht, sips Faturës së dorëzuar nr.2024-100-0148 datë 30.05.2024 (nr ynë.ark.05-2565/1 datë 30.05.2024), Shoqëria Tregtare për Radiodifuzion TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë, kishte për detyrim të paguajë 278.538,00 (dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e tridhjetë e tetë) denarë për kompensim vjetor për lejen e transmetimit televiziv për periudhën nga 27.05.2024, deri në vitin 26.05.2025, përfshirë dhe datën 02.07.2024, si afati i fundit ligjor për pagesën e kompensimit nga Shoqëria Tregtare për Radiodifuzion TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë, e cila nuk ka kryer pagesën në shumë prej 278.538,00 (dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e tridhjetë e tetë) denarë.

III. Në nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 3 të LSHMAAV, është përcaktuar se nëse është konstatuar mosrespektim, shkelje ose cënim i dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore, miratuar në bazë të Ligjit, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në lejen dhe akte të tjera të Agjencisë, kundër botuesit të medias, Këshilli i Agjencisë mund të ndër marrë masë – heqjen e lejes.

Në pajtim me nenin 82 paragrafi (1) nënparagrafët 5 dhe 6 të LSHMAAV, Agjencia do t'i heqë lejen për transmetim televiziv dhe radio, para skadimit të afatit për të cilin i është dhënë dhe do të fshijë transmetuesin nga regjistri i radiodifuzerëve, paraprakisht duke dorëzuar njoftim me shkrim, nëse pas dhënies së lejes do të krijohen rrethana që paraqesin pengesa ligjore për zotëruesin e lejes për të kryer veprimtarinë (neni 82 paragrafi (1) nënparagrafi 5), si dhe nëse zotëruesi i lejes nuk e paguan kompensimin vjetor në afatin e përcaktuar ligjor (neni 82 paragrafi 1 nënparagrafi 6).

Procedura për heqjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio, në pajtim me nenin 83 paragrafi (1) të LSHMAAV, e inicon Këshilli me propozim të drejtorit të Agjencisë.

Në bazë të gjendjes faktike të përcaktuar, Shoqëria Tregtare për Radiodifuzion TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë, nuk i plotëson kushtet minimale kadrovike të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio (neni 62 paragrafi 6 të LSHMAAV dhe neni 21 nga Rregullorja e njëjtë) dhe nuk ka paguar kompensim vjetor për lejen e transmetimit televiziv në afatin e përcaktuar ligjor prej – 30 ditësh nga dita e pranimit të Faturës nr.2024-100-0148 datë 30.05.2024 – nr ynë.ark.05-2565/1 datë 30.05.2024 (neni 80 paragrafi 5 të LSHMAAV), personi i autorizuar nga drejtori i Agjencisë, në bazë të nenit 83 paragrafi (1), dhe në lidhje me nenin 82 paragrafi (1) nënparagrafët 5 dhe 6 të LSHMAAV, dorëzoi Propozimin PA1 nr.08-204 datë 09.07.2024 për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë.

Këshilli i Agjencisë në seancën e 28-të, mbajtur më 10.07.2024, në pajtim me Konkluzionin, ark.nr.02-2978/8 datë 10.07.2024, e miratoi Propozimin, PA1 nr.08-204 datë

09.07.2024, për iniciimin e procedurës për marrjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë.

Në lidhje me procedurën e inicuar për marrjen e lejes të Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë, PA1 nr.08-816 datë 07.09.2023, dhe në pajtim me nenin 82 paragrafi (1) të LSHMAAV Agjencia i dërgoi Njoftim transmetuesit në fjalë (PA1 nr.08-204 datë 11.07.2024), në të cilën thuhet se nëse nuk e dorëzon dokumentacionin e nevojshëm, nga ku mund të konstatohet se i plotëson kushtet minimale kadrovike të përcaktuara në Rregullore për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio, si dhe nëse nuk paguan kompensim vjetor për leje për kryerjen e transmetimit televiziv, në pajtim me nenin 83 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, PA1 nr.08-204 datë 09.07.2024, do të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv, në pajtim me nenin 85 paragrafi (2) të LSHMAAV, dhe transmetuesi do të fshihet nga regjistri i transmetuesve.

Njoftimi PA1 nr.08-204 datë 11.07.2024, i është dorëzuar me shkrim Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë, si dhe përmes postës elektronike në e-mail adresën e transmetuesit të regjistruar si informacion për kontakt në RQRMV dhe të regjistrimit të transmetuesve që udhëhiqet nga Agjencia dhe është pranuar në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 17.07.2024.

Në pajtim me nenin 83 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli është i detyruar që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të propozimit të drejtorit për iniciimin e procedurës për marrjen e lejes, të miratojë vendim me shumicë votash të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit.

Më 19.07.2024, Agjencia, përmes Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit, ka kryer mbikëqyrje të kontrollit administrativ të punës së Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë. Në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer të kontrollit administrativ, ark.nr.03-3151/1 datë 19.07.2024, është konstatuar se transmetuesi nuk i plotëson kushtet minimale kadrovike të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio dhe është propozuar që Këshilli të miraton vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë.

Prandaj, duke marrë parasysh faktin se Shoqëria Tregtare për Radiodifuzion TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë, PA1 nr.08-816 datë 07.09.2023, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e pranimit të Propozimit PA1 nr.08-204 datë 09.07.2024, nga ana e anëtarëve të Këshillit të Agjencisë, nuk ka përmbushur detyrimin e përcaktuar të nenit 62 paragrafi (6) të LSHMAAV dhe neni 21 të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për dhënien e lejes për transmetim televiziv dhe radio, si dhe detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të LSHMAAV, Drejtori i Agjencisë, dorëzoi Propozim PA1 nr.08-204 datë 22.07.2024, për heqjen e lejes për transmetim televiziv të transmetuesit në fjalë.

Këshilli i Agjencisë në bazë të nenit 82 paragrafi (1) nënparagrafët 5 dhe 6 dhe neni 83 paragrafi (3) të LSHMAAV, duke vepruar sipas Propozimit PA1 nr.08-204 datë 22.07.2024, dhe në pajtim me Konkluzionin e Agjencisë, ark.nr.02-3159/2 datë 24.07.2024, miratoi Vendim me të cilën i mirret leja PA1 nr.08-816 datë 07.09.2023 për transmetim televiziv Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë.

Në pajtim me nenin 24 të Rregullores për procedurat e punës financiare dhe kontabël të Agjencisë, nëse zotëruesi i lejes për transmetim televiziv dhe radio nuk kryen pagesën e kompensimit, sipas faturës së dorëzuar në afatin e caktuar në paragrafin (3) të këtij neni të Rregullores, e njëjta anulohet dhe i jepet faturë e re e cila i referohet vetëm periudhës së punës, e cila duhet të paguhet jo më vonë se 8 (tetë) ditë nga dita e lëshimit të saj. Përndryshe pagesa e borxhit, kryhet në rrugë ligjore.

Rrjedhimisht nga sa mësipër, Fatura me nr.2024-100-0148 datë 30.05.2024 (nr ynë.ark.05-2565/1 datë 30.05.2024) për kompensim të lejes për transmetim televiziv, anulohet, dhe Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë, i jipet faturë e re, e cila i referohet vetëm periudhës së punës, pra deri në ditën e miratimit të këtij vendimi për heqjen e lejes dhe që duhet paguar jo më vonë se 8 (tetë) ditë nga dita e dhënies së tij.

Në pajtim me nenin 84 të LSHMAAV, Vendimi për marrjen e lejes për transmetim televiziv është përfundimtar, dhe kundër këtij vendimi, zotëruesi i lejes ka të drejtë që të parashtojë padi për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit. Procedura para gjykatës kompetente është urgjente.

Bazuar në sa mësipër, është marrë Vendim si në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi për marrjen e lejes, Shoqëria Tregtare për Radiodifuzion TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë, ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga pranimi i tij.